

Emertimi dhe Forma ligjore:

NIPT -i:

Adresa e Selise:

Data e krijimit:

Nr. I Regjistrimit Tregtar

Veprimtaria Kryesore:

“BERATEKS” sha ne likujdim

K826070010

Ish Kombinati i Tekstileve Berat

14.12.2007

Import-eksport dhe shitblerje me shumice dhe pakice
te mallrave te ndryshme te industrise tekstile,
mekanike, etj

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2
dhe Ligjit Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

VITI 2019

Pasqyrat Financiare jane individuale

Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek

Pasqyrat Financiare nuk jane te rrumbullakosura

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2019-31.12.2019

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare



Bledar Ahmeti

| Pasqyra e Pozicionit Financiar | Periudha Raportuese | Periudha Para ardhese |
|--|---------------------|-----------------------|
| AKTIVET | | |
| Aktive afatshkurtra | | |
| Mjete monetare | 22,876 | 240,904 |
| Investime | | |
| <i>Te tjera financiare</i> | 0 | 0 |
| Te drejta te arketueshme | | |
| <i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i> | 23,663,661 | 23,663,661 |
| <i>Te tjera</i> | 1,512,591 | 1,512,591 |
| <i>Kapital i nenshkruar i papaguar</i> | 0 | |
| Inventaret | | |
| <i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme (ndihmese)</i> | 0 | 0 |
| <i>Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte</i> | 0 | 0 |
| <i>Produkte te gatshme</i> | 0 | 0 |
| <i>Mallra</i> | 214,800 | 214,800 |
| <i>Parapagime per inventar</i> | 0 | 0 |
| Shpenzime te shtyra | 0 | 0 |
| Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara | 0 | 0 |
| Totali i aktiveve afatshkurtra | 25,413,928 | 25,631,956 |
| Aktive afatgjate | | |
| Aktive financiare | | |
| <i>Tituj te tjere te huadhenies</i> | 0 | 0 |
| Aktive materiale | | |
| <i>Toka</i> | 1,139,075 | 1,139,075 |
| <i>Ndertesa</i> | 7,806,230 | 7,806,230 |
| <i>Impiantë dhe makineri</i> | 0 | 0 |
| <i>Te tjera instalime dhe pajisje</i> | 192,080 | 192,080 |
| <i>Parapagime per aktive materiale dhe ne proces</i> | 0 | 0 |
| Aktivitet biologjike | 0 | 0 |
| Aktive jo materiale | | |
| <i>Emri i mire</i> | 0 | 0 |
| <i>Parapagime per AAJM</i> | 0 | 0 |
| Aktivitet tatimore te shtyra | 0 | 0 |
| Totali i aktiveve afatgjate | 9,137,385 | 9,137,385 |
| TOTALI I AKTIVEVE | 34,551,313 | 34,769,341 |

Likuidatori

Gramos Hazizolli



| Pasqyra e Pozicionit Financiar | Periudha Raportuese | Periudha Para ardhese |
|---|---------------------|-----------------------|
| DETYRIMET DHE KAPITALI | | |
| Detyrime afatshkurtra | | |
| <i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i> | 1,416,000 | 1,360,205 |
| <i>Te pagueshme ndaj punonjesve</i> | 159,510 | 2,976,040 |
| <i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i> | 578,257 | 588,450 |
| <i>Te pagueshme ndaj te treteve</i> | 3,118,038 | 2,030,721 |
| <i>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</i> | | 0 |
| Te ardhura te shtyra | 0 | 0 |
| Provizione | 0 | 0 |
| Totali i detyrimeve afatshkurtra | 5,271,805 | 6,955,415 |
| Detyrime afatgjata | | |
| <i>Detyrime ndaj institucioneve financiare</i> | 0 | 0 |
| <i>Te tjera te pagueshme</i> | 0 | 0 |
| <i>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</i> | 0 | 0 |
| <i>Te ardhura te shtyra (subvencione nga Ministria e Financave)</i> | 0 | |
| Provizione | | |
| <i>Provizione per pensione</i> | 0 | 0 |
| Detyrime tatimore te shtyra | 0 | 0 |
| Totali i detyrimeve afatgjata | 0 | 0 |
| Detyrime totale | 5,271,805 | 6,955,415 |
| Kapitali dhe Rezervat | | |
| Kapitali i nenshkruar | 156,504,900 | 156,504,900 |
| Rezerva rivleresimi | 0 | 0 |
| Rezerva te tjera | | |
| <i>Rezerva ligjore</i> | 11,882,657 | 11,882,657 |
| <i>Rezerva te tjera</i> | 62,784,893 | 62,784,893 |
| Fitimi/(humbja) e pashperndare | (203,358,524) | (201,728,264) |
| Fitimi/(humbja) e periudhes | 1,465,582 | (1,630,260) |
| Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike | 29,279,508 | 27,813,926 |
| Interesa jo-kontrollues | | |
| Totali i kapitalit | 29,279,508 | 27,813,926 |
| TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT | 34,551,313 | 34,769,341 |

Likuidatori

Gramos Hazizolli

| | Periudha Raportuese | Periudha Para ardhese |
|---|---------------------|-----------------------|
| Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit | | |
| Te ardhurat nga aktiviteti kryesor | 0 | 0 |
| Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit | 0 | 0 |
| Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces | 0 | 0 |
| Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar | 0 | 0 |
| Te ardhura te tjera te shfrytezimit | 5,600,000 | |
| Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme | | |
| Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme | 0 | 0 |
| Te tjera shpenzime-transp+punt.transporti | | 0 |
| Shpenzime te personelit | | |
| Paga dhe shperblime | (780,000) | (780,000) |
| Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsove | (130,260) | (130,260) |
| Personel -keshill mbikqyres | (2,346,360) | |
| Personel sherbimi-kontabilist,auditues | (612,000) | 0 |
| Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale | 0 | 0 |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | | 0 |
| Shpenzime te tjera shfrytezimi | (340,498) | (720,000) |
| Te ardhura te tjera | 84,000 | |
| Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit* | 0 | 0 |
| Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra-Kapital i papaguar | | 0 |
| Shpenzime financiare | | |
| Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme | (9,300) | |
| Shpenzime te tjera financiare | | |
| Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesemarrjet | 0 | 0 |
| Te tjera (pershkruaj) | 0 | 0 |
| Fitimi/(humbja) para tatimit | 1,465,582 | (1,630,260) |
| Tatimi mbi fitimin | | |
| Tatimi mbi fitimin e periudhes | 0 | 0 |
| Tatim fitimi i shtyre | 0 | 0 |
| Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve | 0 | 0 |
| Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A) | 1,465,582 | (1,630,260) |
| Te ardhura te tjera gjithepershiresë per periudhen/vitin: | | |
| Diferenca (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja | 0 | 0 |
| Te tjera (pershkruaj) | 0 | 0 |
| Totali i te ardhurave te tjera gjithepershiresë per periudhen/vitin (B) | 0 | 0 |
| Totali i te ardhurave gjithepershiresë per periudhen/vitin (A+B) | 1,465,582 | (1,630,260) |
| Te ardhurat nga aktiviteti kryesor | 0 | 0 |

Likuidatori

Gramos Hazizolli

| Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (metoda indirekte) | Periudha Raportuese | Periudha Para ardhese |
|--|------------------------|--------------------------|
| Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit: | | |
| Fitimi/(Humbja) e periudhes | 1,465,582 | (1,630,260) |
| Rregullime per te ardhura dhe shpenzime jo-monetare: | | |
| <i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i> | 0 | 0 |
| <i>Shpenzime te shtyra</i> | 0 | 0 |
| <i>Vlera e aktiveve te shitura</i> | 0 | 0 |
| Fluksi i mjeteve monetare i perfshire ne aktivite investuese | | |
| <i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i> | | |
| Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit | | |
| Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera | 0 | (144,000) |
| Rënie/(rritje) në inventarë | 0 | 0 |
| Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme | 55,796 | 864,000 |
| Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit | (2,816,530) | 910,260 |
| Rritje/(rënie) në detyrime tjera | 1,077,125 | |
| Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit | (218,028) | 0 |
| Tatim fitimi i paguar gjate periudhes | 0 | 0 |
| Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit | | |
| <i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i> | 0 | 0 |
| <i>Dalje e aktiveve afatgjata materiale</i> | 0 | 39,669,017 |
| <i>Zvogelim Kapitali</i> | 0 | (39,669,017) |
| Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit | 0 | 0 |
| Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit | | |
| <i>Subvencione nga buxheti I shtetit</i> | 0 | 0 |
| <i>Pagese e detyrimeve te huave</i> | 0 | 0 |
| Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit | 0 | 0 |
| Rritje/(rënie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to | (218,028) | 0 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim | 240,904 | 240,904 |
| Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare | | |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund | 22,876 | 240,904 |

Likuidatori

Gramos Hazizolli

| | Kapitali i nenshkruar | Rezerva ligjore | Rezerva te tjera (pershkruaj) | Fitimet/ (humbjet) e pashperndara | Fitim/(hum bja) e periudhes | Totali |
|---|--------------------------|--------------------|-------------------------------------|---|-----------------------------------|-------------|
| Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto | | | | | | |
| Pozicioni financiar ne fillim | 156,504,900 | 11,882,657 | 62,784,893 | (201,728,264) | | 29,444,186 |
| Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile | | | | | | 0 |
| Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim | 156,504,900 | 11,882,657 | 62,784,893 | (201,728,264) | 0 | 29,444,186 |
| Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes: | | | | | | 0 |
| Fitim/(humbja) e periudhes | | | | | (1,630,260) | (1,630,260) |
| Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse | | | | | | 0 |
| Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital | | | | | | 0 |
| Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen | 0 | 0 | 0 | 0 | (1,630,260) | (1,630,260) |
| Transaksione per pronaret e njësish ekonomike te njohura direkt ne kapital: | | | | | | 0 |
| Emetim i kapitalit të nënshkruar | | | | | | 0 |
| Dividende te shperndare | | | | | | 0 |
| Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj) | | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali i transaksioneve per pronaret e njësish ekonomike | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes) | 156,504,900 | 11,882,657 | 62,784,893 | (201,728,264) | (1,630,260) | 27,813,926 |
| Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes: | | | | | | 0 |
| Fitim/(humbja) e periudhes | | | | | 1,465,582 | 1,465,582 |
| Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse | | | | | | 0 |
| Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital | | | | | | 0 |
| Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen | 0 | 0 | 0 | 0 | 1,465,582 | 1,465,582 |
| Transaksione per pronaret e njësish ekonomike te njohura direkt ne kapital: | | | | | | 0 |
| Emetim i kapitalit të nënshkruar | | | | | | 0 |
| Dividende te shperndare | | | | | 0 | 0 |
| Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj) | | | | (1,630,260) | 1,630,260 | 0 |
| Totali i transaksioneve per pronaret e njësish ekonomike | 0 | 0 | 0 | (1,630,260) | 1,630,260 | 0 |
| Pozicioni financiar ne fund (viti aktual) | 156,504,900 | 11,882,657 | 62,784,893 | (203,358,524) | 1,465,582 | 29,279,508 |

Likuidatori

Gramos Hazizolli

SHENIMET SHPJEGUESE**1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqeria "Berateks" sha ne likujdim, eshte regjistruar si person juridik ne date 07.02.2008, me adrese: Ish-Kombinati i Tekstileve Berat, Shqiperi, me NIPT (NUIS) K826070010 Kapitali i nenshkruar i shoqerise eshte 156,505,883 leke, likuidator i shoqerise eshte Z. Gramos Hazizolli.

Keshilli Mbikqyres i shoqerisegjate vitit 2019 eshte i perbere nga:

Kryetar: Z. Vasil Pano
Anetar: Znj. Anisa Tresa
Anetar: Znj. Aferdita Kareco
Anetar: Znj. Lilozeta Feto

Ne perputhje me Vendimin e Asamblese e Pergjithshme te Aksionareve, njoftuar me shkresen nr 21671 date 26.11.2019, Shoqeria "Berateks" sha ne likujdim eshte ne proces bashkimi me perthithje nga shoqeria "Petrolalba" sha ne likujdim.

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas Ligjit Nr.9901 date 14/04/2008 "*Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare*" statutit te saj dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*". Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "*Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre*", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë nuk janë përgatitur mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar, pasi shoqëria eshte ne proces likujdimi.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas

përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbchen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

| Kursi i këmbimit | 2019 | 2018 |
|------------------|--------|--------|
| Euro/LEK | 121.77 | 123.42 |
| USD/LEK | 108.64 | 107.82 |

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë



Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

| Kategoria e aktiveve | Metoda e Amortizimit | Norma e Amortizimit |
|----------------------|----------------------|---------------------|
| Mobilje për zyren | Vlera e mbetur | 20 % |
| Pajisje informatike | Vlera e mbetur | 25 % |
| Të tjera | Vlera e mbetur | 20% |

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat


Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.



3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 5% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore. Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër.

Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të

parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci kontabel, aktivët

4. Aktive monetare

Gjendja e aktiveve monetare ne date 31.12.2019 eshte ne shumen 22,876 leke, e cila perfaqeson gjendjen e mjeteve monetare ne Tirana Bank dhe Arke.

| Nr | Aktive Monetare | Viti 2019 | Viti 2018 |
|----|-------------------|---------------|----------------|
| 1 | Depozita ne banke | 17,547 | 155,522 |
| 2 | Arka | 5,329 | 85,382 |
| | Totali | 22,876 | 240,904 |

Gjendja e likujditeteve, detyrimet dhe kerkesat ndaj te treteve ne monedhe te huaj gjendje ne 31.12.2019 jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2019 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane marre ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

5. Te drejta te arketueshme

Paraqitet gjendja e te drejtave te arketueshme me 31.12.2019, si me poshte:

| Nr | Te drejta te arketueshme | Viti 2019 | Viti 2018 |
|----|-------------------------------|-------------------|-------------------|
| 1 | Nga aktiviteti i shfrytezimit | 23,663,661 | 23,663,661 |
| 2 | Te tjera-TVSH | 508,050 | 508,050 |
| 3 | Te tjera-Debitore te tjere | 1,004,541 | 1,004,541 |
| | Totali | 25,176,252 | 25,176,252 |

5.1 Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit

Paraqitet gjendja e kerkesave nga aktiviteti i shfrytesimit ne shumen 23,663,661 leke, si me poshte vijon:

| Nr | Klientet | Viti 2019 | Viti 2018 |
|----|-------------------------|-------------------|-------------------|
| 1 | Matuka shpk (ish Stela) | 21,042,373 | 21,042,373 |
| 2 | Albaxenis shpk | 1,969,174 | 1,969,174 |
| 3 | Te tjere | 652,114 | 652,114 |
| | Totali | 23,663,661 | 23,663,661 |



5.2 Te tjera te arketueshme-TVSH

Paraqitet gjendja e TVSH-se kreditore me 31.12.2019 prej 508,050 leke, e pandryshuar nga viti 2018.

5.3 Te tjera te arketueshme

Paraqitet gjendja debitore te tjere me 31.12.2019 prej 1,004,541 leke e pa ndryshuar nga viti 2018.

6. Inventaret

Paraqitet gjendja e inventarit me 31.12.2019, ne shumen 214,800 leke, dhe eshte e detajuar si me poshte:

| Nr | Inventaret | Viti 2019 | Viti 2018 |
|----|--|-----------------------|-----------------------|
| 1 | Mbeturina Tekstili ;2100 kg x 80 lek/kg | 168,000 | 168,000 |
| 2 | Mbeturina Hekuri-skrap 2800 kg x 18 lek/kg | 46,800 | 46,800 |
| | Totali | <u>214,800</u> | <u>214,800</u> |

7. Aktive afatgjata

Gjendja e aktiveve afat gjata me 31.12.2019 eshte 9,137,385 leke, e grupuar si me poshte:

| Nr | Emertimi | Viti 2019 | Viti 2018 |
|----|------------------------|-------------------------|-------------------------|
| 1 | Toka | 1,139,075 | 1,139,075 |
| 2 | Ndertesa | 7,806,230 | 7,806,230 |
| 3 | Makineri e paisje | 151,248 | 151,248 |
| 4 | Te tjera -Kasa fiskale | 40,832 | 40,832 |
| | Totali | <u>9,137,385</u> | <u>9,137,385</u> |

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e kostos (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018.

Bilanci kontabel, pasivet

8. Detyrimet Afatshkurtra

Ne kete post paraqitet gjendja e detyrimeve afatshkurtra me 31.12.2019 ne shumen 5,271,805 leke.

| Nr | Detyrimet afatshkurtra | Viti 2019 | Viti 2018 |
|----|--|-------------------------|-------------------------|
| 1 | Te pagueshme per aktivitetin e shrytezimit | 1,416,000 | 1,360,205 |
| 2 | Te pagueshme ndaj punonjesve | 159,510 | 2,976,040 |
| 3 | Te pagueshme per detyrime tatimore | 578,257 | 588,450 |
| 4 | Te pagueshme ndaj te treteve | 3,118,038 | 2,030,721 |
| | Shuma | <u>5,271,805</u> | <u>6,955,416</u> |

8.1 Te pagueshme per aktivitetin e shrytezimit

Ne kete post jane te perfshira detyrimet e shoqerise ndaj furnitoreve ne 31.12.2019 ne shumen 1,416,000 leke. Kjo vlere eshte e analizuar per cdo furnitor si me poshte vijon:

| Nr | Detyrimet per furnitoret | Viti 2019 | Viti 2018 |
|----|--------------------------|-------------------------|-------------------------|
| 1 | Qani Kajo | 540,000 | 540,000 |
| 2 | Lezaj Audit | 84,000 | 84,000 |
| 3 | Vullnetare Cela | 360,000 | 360,000 |
| 4 | Naim Malo | 180,000 | 180,000 |
| 5 | Lejla Shahu | 252,000 | |
| 6 | Hodo Hasani | | 72,000 |
| 7 | Detyrime tjera | | 124,205 |
| | Shuma | <u>1.416.000</u> | <u>1.360.205</u> |

8.2 Te pagueshme ndaj punonjesve

Ne kete post eshte i perfshire detyrimi i shoqerise ndaj likuidatorit ne 31.12.2019 ne shumen 159,510 leke.

| Nr | Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore | Viti 2019 | Viti 2018 |
|----|---|-----------------------|-------------------------|
| 1 | Paga personeli | 159,510 | 2,976,040 |
| 2 | Detyrime tatimore (sigurime, TAP, tat.burim) | 578,256 | 588,450 |
| | Shuma | <u>737.766</u> | <u>3.564.490</u> |

8.3 Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore ne shumen 578,256 leke, me 31.12.2019 paraqiten si me poshte:

| Nr | Detyrimet tatimore | Viti 2019 | Viti 2018 |
|----|---|-----------------------|-----------------------|
| 1 | Tatim mbi te ardhurat e personale | 4,550 | - |
| 2 | Tatim ne burim | 555,571 | - |
| 3 | Detyrime tatimore (sigurime shoq/shend) | 18,135 | 588,459 |
| | Shuma | <u>578.256</u> | <u>588.459</u> |

8.4 Te tjera te pagueshme

Paraqitet shuma e detyrimit per Keshillin Mbikqyres deri me 31.12.2019, si me poshte:

| Nr | Detyrim Keshilli Mbikqyres | Viti 2019 | Viti 2018 |
|----|--|-------------------------|-------------------------|
| 1 | Vaso Pano (Kryetar) | 742,254 | 187,272 |
| 2 | Lilozeta Feto (Antare) | 733,686 | 62,424 |
| 3 | Aferdita Kareco (Antare) | 694,926 | 62,424 |
| 4 | Anisa Treza (Antare) | 135,660 | |
| 5 | Fran Ibrahimimi (Antar) | 124,848 | 124,848 |
| 6 | Fatjona Kuka (Antare) | 686,664 | 686,664 |
| | Tatim burim (I pa krijuar ne 31.12.2018) | | 187,089 |
| | Hodo Hasani -Kontabilist | | 720,000 |
| | Shuma | <u>3.118.038</u> | <u>2.030.721</u> |



Sqarohet se vlerat e tatimit në burim të pakrijuar për detyrimet e Keshillit mbikqyres me 31.12.2018 (detyrimet ishin paraqitur në vlerat e tyre bruto), prej 187,089 leke, u krijuar dhe së bashku me detyrimet për vitin 2019 janë paraqitur si tepricë e akumuluar të zeri tatim në burim të rubrika detyrimet tatimore.

9. Kapitali

Kapitalet e veta janë në shumën 29,279,508 leke. Kapitale të veta janë shtuar me rezultatin e vitit ushtrimor për 1,465,582 leke. Të detajuara janë në tabelën e mëposhtme:

| Nr | Emertimi | Kapitali I regjistruar | Rezervat | Fitime/humbje të pashperndara | Fitimi/humbja e vitit | Totali |
|----|-----------------------|------------------------|-------------------|-------------------------------|-----------------------|-------------------|
| 1 | Gjendja me 31.12.2018 | 156,504,900 | 74,667,550 | (201,728,264) | (1,630,260) | 27,813,926 |
| 2 | Shtesat për 2019 | - | - | (1,630,260) | 1,465,582 | (164,678) |
| 3 | Paksimet për 2019 | - | - | - | 1,630,260 | 1,630,260 |
| 4 | Gjendja me 31.12.2019 | <u>156,504,900</u> | <u>74,667,550</u> | <u>(203,358,524)</u> | <u>1,465,582</u> | <u>29,279,508</u> |

Pasqyra e Performances

10. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Gjatë vitit 2019 shoqëria është financuar nga MFE me një vlerë prej 5,600,000 leke.

Janë pasqyruar të të ardhura të tjera edhe një vlerë e financuar nga MFE në vitin 2017, por e përgjithshme prej 84,000 leke.

11. Shpenzimet e vitit 2019 paraqiten si vijon;

Totali i kostos për vitin 2019 është 4,218,418 leke, si më poshtë.

| Emertimi | Viti 2019 | Viti 2018 |
|--|-------------------------|-------------------------|
| Shpenzime për paga | 780,000 | 780,000 |
| Sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 130,260 | 130,260 |
| Personel jashtë Shoqërisë (kontabilist+eksperte) | 612,000 | 720,000 |
| Keshilli mbikqyres | 2,346,360 | |
| Të tjera -Transport dhe punt.transporti | 155,522 | |
| Gjoha | 184,976 | |
| Komisione bankare | 9,300 | |
| Shuma | <u>4,218,418</u> | <u>1,630,260</u> |

12. Llogaritja e rezultatit tatimor

Për vitin ushtrimor 2019 shoqëria paraqitet me rezultat në shumën 1,465,582 leke, si më poshtë:

| Nr | EMERTIMI | VITI 2019 | VITI 2018 |
|----|------------------------|------------------|--------------------|
| 1 | Të ardhura | 5,684,000 | - |
| 2 | Shpenzime | (4,218,418) | (1,630,000) |
| 3 | Rezultati | <u>1,465,582</u> | <u>(1,630,000)</u> |
| 4 | Shpenzime të panjohura | <u>184,976</u> | - |

| | | | |
|---|--|------------------|--------------------|
| 5 | Fitimi I tatueshem | <u>1,650,558</u> | <u>(0)</u> |
| 6 | Humbje e mbartur (e vitit 2018 dhe para saj) | <u>1,650,558</u> | <u>-</u> |
| 7 | Tatim Fitimi | <u>0</u> | <u>0</u> |
| 8 | Fitimi neto | <u>1,465,582</u> | <u>(1,630,000)</u> |

13. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqëria është e përfshirë në dy çështje gjyqesore të hapur nga ajo.

14. Ngjarje pas datës së Bilancit

Situata e krijuar gjatë periudhës së fatkeqesise natyrore, të shpallur si pasoje e COVID-19, nuk ndikon në aktivitetin tone, pasi Shoqëria “Berateks” sha ne likujdim është në proces bashkimi me perthithje nga shoqëria “Petrolalba” sha.

Likuidatori

Gramos Hazizolli



Hartuesi

Hodo HASANI

